STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 27 tetor 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) VENDOS QENDREN E LEVIZSHME TE KOMANDES TE DFS-SE NE QYTETIN E NJU JORKUT (NEW YORK CITY) DHE LONG AJLEND (LONG ISLAND) PER TE SIGURUAR NDIHME NE VAZHDIM PER BANORET E NJU JORKUT (NEW YORKERS)

Ndihma e DFS-së për kërkesat e sigurimit, ndihmën e hipotekave dhe çështje të tjera e disponueshme gjatë vizitave të Qendrës së Lëvizshme të Komandës javën e ardhshme

Familjeve dhe bizneseve te prekura gjithashtu u bëhet thirrje t'i telefonojnë linjës për katastrofën të DFS-së në 1-800-339-1759

Ndërsa afrohet përvjetori i parë i super stuhisë Sendi (Sandy), Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) është duke vendosur Qendrën e Lëvizshme të Komandës (MCC) të Departamentit të Shërbimeve Financiare (DFS) për të siguruar ndihmë në vazhdim për pronarët e shtëpive dhe bizneset e prekura nga stuhia. Përfaqësuesit e DFS-së do të jenë të disponueshëm javën e ardhshme në Qytetin e Nju Jorkut (New York City) dhe në Long Ajlënd (Long Island) për të ofruar ndihmë në lidhje me çështjet e sigurimit, ndihmën e hipotekave dhe çështje të tjera.

"Kemi bërë përparim të konsiderueshëm në rindërtim pas dëmit të tmerrshëm të shkaktuar nga super stuhia Sendi (Sandy), por ka ende më shumë punë përpara," tha Guvernatori Kuomo. "Do të vazhdojmë të punojmë për të ndihmuar ata banorë të Nju Jorkut (New Yorkers) që janë duke u ndeshur ende me sfida në riparimin e shtëpive dhe jetës së tyre pas kësaj katastrofe shkatërruese natyrore. Shteti i Nju Jorkut (New York State) do të vazhdojë të japë ndihmë për familjet dhe bizneset e prekura derisa puna të jetë kryer."

Benxhëmin M. Loski (Benjamin M. Lawsky), Kryeinspektori i Shërbimeve Financiare, tha, "Ndërsa shumë kërkesa të sigurimeve në lidhje me super stuhinë Sendi (Sandy) janë zgjidhur tashmë, ato që mbeten janë mes rasteve më të vështira. Guvernatori Kuomo (Cuomo) na vendosi në terren që të vazhdojmë të bëjmë gjithshka që mundemi për të ofruar ndihmë të drejtpërdrejtë për pronarët e shtëpive dhe bizneseve të Nju Jorkut (New York) që po rindërtohen pas stuhisë."

Përfaqësuesit e DFS-së do të jenë të disponueshëm javën e ardhshme për t'u takuar me banorët brenda

Qendrës së Lëvizshme të Komandës të Departamentit, e cila do të vendosur në vendndodhjet e mëposhtme në datat e mëposhtme ndërmjet orës 9:00 të mëngjesit dhe 5:00 të pasdites:

E hënë, 28 tetor
Siller Foundation Relief Center
2145 Hylan Blvd.
Stejtën Ajlënd (Staten Island), NY

E martë, 29 tetor
Gerritsen Beach Library
2808 Gerritsen Avenue
Bruklin (Brooklyn), NY

E mërkurë, 30 tetor
The Howard Beach Library
92-06 156th Avenue
Hauard Biç (Howard Beach), NY
E enjte, 31 tetor
Freeport Memorial Library
144 W Merrick Road
Friport (Freeport), NY

E premte, 1 nëntor
Lindenhurst Memorial Library
1 Lee Avenue
Lindenhërst (Lindenhurst), NY

E shtunë, 2 nëntor
Community Church of the Nazarene
1414 Central Avenue
Far Rokëuej (Far Rockaway), NY

Familjeve dhe bizneseve të prekura u kërkohet gjithashtu t'i telefonojnë linjës për katastrofën të DFS-së për ndihmë në 1-800-339-1759, e cila është e disponueshme çdo javë të hënën deri të premten ndërmjet orës 8:30 të mëngjesit dhe 4:30 të pasdites.

Deri në tetor 2013, më shumë se 98 përqind e afërsisht 500,000 kërkesave të sigurimit jo të përmbytjes në rajonet e prekura nga Sendi (Sandy) të Nju Jorkut (New York) janë zgjidhur – me më shumë se $5 miliardë në kërkesa të paguara. Megjithatë, këto kërkesa që mbeten pezull janë shpesh rastet më të vështira ose sfiduese. DFS mund të ofrojë ndihmë për banorët e prekur të Nju Jorkut (New Yorkers) në procesin me ndërmarrjen e tyre të sigurimit. Përveç kësaj, DFS mund të ndihmojë në krijimin e një procesi vullnetar të ndërmjetësimit për pronarët e shtëpive dhe bizneset në mosmarrëveshje në lidhje me kërkesat e sigurimit

të tyre ose për ata që janë të pakënaqur me mohimet e kërkesave të tyre që rrjedhin nga Sendi (Sandy). Pronarët e shtëpive duhet të vënë re, megjithatë, se dëmi nga përmbytja përgjithësisht mbulohet vetëm nga sigurimi ndaj përmbytjes, që është një program federal i administruar nga FEMA. Përfaqësuesit e DFS-së mund të ofrojnë këshilla dhe udhëzime për banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) në kontaktimin e programit federal të sigurimit ndaj përmbytjes në lidhje me ato kërkesa.

DFS gjithashtu mund të ndihmojë pronarët e shtëpive të prekur për çështjet që kanë lidhje me hipotekat e tyre. Në veçanti, disa familje mund të kenë arritur ose janë pranë përfundimit të një falje të hipotekës që morën pas stuhisë. DFS mund të ndihmojë pronarët e shtëpive në procesin me bankën ose agjencinë e hipotekës së tyre mbi atë çështje, përfshirë alternative të mundshme për ndryshime të hipotekës.

Pronarët e shtëpive ose bizneseve që nuk janë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjet me institucionin financiar të tyre mund të kontaktojnë DFS-në për të paraqitur një ankesë në 1-800-342-3736 ose në faqen në internet të DFS-së. Përveç kësaj, DFS gjithashtu ka nxjerrë një listë të "50 këshillave kryesore të përgatitjes për stuhinë" për të ndihmuar që të sigurohet se banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) janë të pajisur më mirë për t'u mbrojtur kundër dëmit të mundshëm që mund të shkaktojnë stuhitë e ardhshme.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418